



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORE
SEKTORI JURIDIK

nr. 1949/Prot
17-07-2017

Nr. 1295 Prot

Vlorë, më 11 . 07 . 2017

Lënda: Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Himarë.

Drejtuar: Z.Jorgo Goro,
KRYETAR.

Për dijeni: Këshillit të Bashkisë

HIMARË

Në mbështetje dhe zbatim të neneve 8 dhe 16 të Ligjit nr.107/2016, "Për Prefektin", shprehemi si më poshtë:

1.Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.116, datë 29.06.2017 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-30 qershor 2017", sqarojmë se:

Bazuar në nenin 6 pika 1 dhe nenin 11 pika 2, të Ligjit nr.44/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9355", si dhe V.K.M nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmave ekonomike", ndihmat ekonomike shpërndahen 1 herë në muaj, me vendim të strukturave rajonale të shërbimit social shtetëror.

Institucioni i Prefektit nuk mund të shprehet mbi ligjshmërinë e vendimit, pasi duhet t'i referoheni ndryshimeve të ligjit.

2.Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.117, datë 29.06.2017 "Mbi dhënien e një ndihme , për z.Mersin Gockaj, nga fondi i emergjencës për djegien e shtëpisë së tij" **vlerësohet i ligjshëm, si procedurë.**

Në vëmendje: Të vijojnë procedurat në zbatim të kërkesave ligjore.



PREFEKTI

Etjona HOXHA
Etjona HOXHA